



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 28.

Prishtinë, më 22.12.2015, në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Drilon Asllani-Radio Dukagjini, Nora Kelmendi-KDI, Valmire Hoti-RTV 21, Edona Kurteshi-Kosovalive, Osman Shatri-HANDIKOS, Dalina Kërçeli-YIHR, Mexhit Foniqi-Shoqata e Personave të Verbër të Kosovës, Ukë Gashi-ZPRK, Bajram Shake Jetullahu-GKVK, Halil Kurmehaj-KGVK, Lejla Selimi-OSCE.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nr.27;
3. Shqyrtimi i Propozim Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësive të Avokatit të Popullit;
4. Diskutim për sfidat me të cilat ballafaqohet Komitetit i Grave të Verbra të Kosovës;

- Të ftuar: Përfaqësueset e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës,
5. Të ndryshme.

Kryetarja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika e dytë, pasi që procesverbali i mbledhjes së 27-të, nuk është bërë gati me kohë.

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar.

3. Shqyrtimi i Propozim Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësive të Avokatit të Popullit;

Kryetarja, tha se propozim rregullorja e hartuar nga Grupi Punues, të cilin e ka autorizuar Komisioni, ka mbajtur katër takime të grupit punues,. Kemi punuar në pajtim me ligjin për Avokatin e Popullit. Në grup punues në një takim ka qenë prezent edhe Avokati i Popullit, Drejtoria Ligjore e Kuvendit, të cilët na kanë mbështetur, kështu që ne sot para vetes kemi një propozim rregullorë e cila sqaron mënyrën e procedimit të zgjedhjes së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit në Kuvend.

Ajo tha se këtë propozim rregullorë nga grupi punues e keni pasur me kohë dhe nuk po e shoh të nevojshme të diskutojmë nen për nen. Nëse dikush ka ndonjë propozim mund të japë mendimin tani në komision.

Mexhide Mjaku-Topalli, fillimisht lavdëroi punën që ka bërë grupi punues në hartimin e kësaj rregulloreje dhe tha se është bërë një punë e mirë për sqarimin e ligjit. Ajo kërkoi disa sqarime nga kryetarja, dhe pas sqarimeve të nevojshme edhe njëherë falënderoi dhe përgëzoi për punën e grupit punues.

Kryetarja, konstatoi se pas shqyrtimit të Propozim rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësive të Avokatit të Popullit; Komisioni, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni miratoi Propozim rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësive të Avokatit të Popullit, dhe e procedon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

4.Diskutim për sfidat me të cilat ballafaqohet Komitetit i Grave të Verbra të Kosovës;Të ftuar: përfaqësueset e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës;

Kryetaraja, tha se kemi përfaqësueset e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës, dhe brenda kompetencave tona do mundohem të transmetojmë kërkesat e juaja te zbatuesit kompetent të ligjit.

Bajramshahe Jetullau, e falënderoi komisionin për pritjen dhe tha se komuniteti i Grave të Verbra ballafaqohet me sfida të shumta, sa i përket ligjit për personat e verbër, ekziston vetëm në letër, pothuajse përveç nenit 7, nenet tjera nuk zbatohen.

Halil Kurmehaj, theksoi se komuniteti i të verbërve dhe grave të verbra ballafaqohet me probleme të mëdha, korniza ligjore për këta persona nuk zbatohet, po ashtu ligji është edhe i paqartë, nuk jemi pajisur me librezë të verbësisë. Ky proces zvarritet, personat që marrin këtë librezë detyrohen të paguajnë anëtarësinë, në bazë të ligjit.

Ai tha se personat me aftësi të kufizuara gjegjësisht personat e verbër, kanë problem me punësimin ku nuk zbatohet ligji i punës, me ç'rast në çdo organizatë që ka mbi 50 të punësuar, një të jetë me aftësi të kufizuara,

Kryetarja, tha se Komisioni ka bërë monitorimin e zbatimit të ligjit për personat e verbër dhe kemi bërë disa rekomandime ku kemi vërejtur se ka mangësi, ideja e një ligji gjithëpërfshirës do të ishte diçka shumë e mirë por në pamundësi të realizimit tani, ne do të bëjmë përpjekje që të kërkojmë shërbimet e duhura dhe një përkushtim më të theksuar te të gjithë ata që i obligon ligji.

Salihe Mustafa, tha se shumicën e vërejtjeve që i thanë përfaqësuesit e këtij komuniteti, ne i kemi identifikuar gjatë vizitave për monitorimin e ligjit për personat e verbër, dhe kemi bërë rekomandimet. Rekomandimi kryesorë është ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji sepse kemi vërejtur se ligji nuk zbatohet, sepse ka mangësi dhe kompetenca të përziera në ligj. Sa i përket punësimit, u tha se nuk zbatohet dispozita, kjo është sepse ata që nuk e zbatojnë dispozitën nuk po ndëshkohen, kemi vërejtur se personat e verbër nuk lirohen nga pagesa e taksave, kështu që vërejtjet e juaja do t'i kemi parasysh dhe kur të vjen ligji në plotësim ndryshim, do të kemi një bashkëpunim më të ngushtë në mënyrë që baza ligjore të jetë në rregull dhe të kemi një ligj të zbatueshëm.

Nenad Rashiq, tha se ligji për aftësim dhe riaftësim profesional është që në 50 punëtorë të punësuar, një të jetë me aftësi të kufizuara. Me sa kam kuptuar, kemi dy propozime e para që disa nene nuk po zbatohen mirë apo fare, nëse është kjo, mundemi që ministrinë përkatëse prapë t'i thërrasim apo t'i obligojmë që të bëjnë zbatimin e dispozitave përkatëse. U përmend edhe mundësia e ndryshimit të ligjit. Nuk e di, a janë krijuar kushtet për ndryshimin e këtij ligji, po krijohet problem kur një institucion tjetër po harton ligjin dhe tjetri institucion po është zbatues i ligjit.

Bajramshahe Jetullahu, tha se te neni 5, te çështja e punësimit ndihemi të diskriminuar. Më herët ka qenë, nëse nuk gabo, në 20 apo 25 punëtorë, me qenë një i punësuar me aftësi të kufizuara, dhe ajo që u tha se nëse një institucion apo organizatë punëdhënëse nuk donë të ketë një person me aftësi të kufizuara të punësuar, atëherë të grumbullojë

mjete sa për t'ja paguar një personi një pagë. Unë këtë e quaj një lloj lëmoshe, për shkak se po bëhen investime në arsimimin e personave me aftësi të kufizuara, konkretisht të verbërve. Ne kërkojmë që këta të mund të punësohen, të japin kontributin e tyre, dhe po luftojmë t'i shkollojmë fëmijët dhe çka t'ju themi ne, shkollohuni, investoni dhe prapë mbeteni papunë.

Salihe Mustafa : Ligji për aftësim dhe riaftësim profesional është kompetencë e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, por të gjitha që ju i thatë, ne edhe si komision edhe si deputetë do të bëjmë përpjeke që të japim kontributin në atë ligj që të drejtat e juaja të realizohen.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se kemi bërë monitorimin e këtij ligji, kemi realizuar shumë vizita, ligji për arsim para universitar thotë se në shkolla të rregullta duhet të këtë gjithëpërfshirje, kuptohet edhe këto kategori, kështu që janë duke punuar në plane dhe strategji për të realizuar planin individual të arsimit. Janë shqetësuese ato nene të këtij ligji, që nuk po zbatohen. E kam shpreh shqetësimin edhe në takimin paraprak me përfaqësuesit e ministrive, për lirimin nga pagesat e taksave rrymës shpenzimet e udhëtimit, për të gjitha këto, ne kemi bërë rekomandimet dhe presim që ato do të implementohen. Ne do të jemi përsëri bashkë dhe t'i shtyjmë proceset përpara.

Kryetarja, tha se të gjitha ato çka u thanë, ne i kemi evidentua. Kemi për obligim aty ku mundemi të ndikojmë që të kemi progres në këtë drejtim.

5. Të ndryshme.

Kryetarja, tha se grupi punues që është duke shqyrtuar Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, do të raportojë lidhur me punën dhe takimet që janë duke i bërë.

Salihe Mustafa, njoftoi për punën që është duke e bërë grupi punues për shqyrtimin e projektligjit dhe tha se KDI ka angazhuar një ekspert për të ofruar një hulumtim. Sot patëm takimin e grupit punues, ku ishin prezent edhe Zyra Ligjore e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Financave, kishim të ftuar edhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por ata nuk ju përgjigjën ftesës,

Kemi kërkuar nga Ministria e Financave, që të paraqesin edhe koston sekondare për këtë projektligj sepse ligji për të qenë i zbatueshëm duhet ti parasheh edhe këto sepse Ministria e Shëndetësisë duhet të paguajë premiumet shëndetësore, edhe kujdesin shëndetësor shtëpiak, ka implikime buxhetore që prekin gjithashtu edhe Ministrinë e Arsimit dhe Infrastrukturës. Kemi kërkuar sqarime shpesh nga aktorët kryesorë sepse kur të miratohet si ligj, dëshirojmë që ai edhe të jetë i zbatueshëm.

Kujtim Paçaku, tha se sa i përket këtij projektligji, po i referohem kontakteve që i kam pasur me pikat e këtij asociacioni në Prizren. Kuptova se qendra e Hendikosit qenka e ndarë prej qendrave të tjera lokale dhe paraqet shqetësimin e pjesëtareve të Hendikosit në Prizren, të cilët nuk kanë arritur të hynë në buxhetin e qeverise lokale dhe tani ky është

një kërcënim dhe rrezik permanent për këtë asociacion. Më herët qendra e Handikosit në Prishtinë i ka pasur ndërlidhjet me qendrat e tjera. Do të hasim në ankesa të shumta vitin e ardhshëm nga Prizreni sepse është një numër shumë i madh i personave me aftësi të kufizuar, pasi këtë vit nuk arritëm me vizitua Departamentin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Komunitete në Prizren. Pas pushimeve, të bëhet vizita e parë në Prizren dhe të ftohen edhe pjesëtarët nga Handikosit, që kishim me e krye një obligim dhe të shohim si do ta bëjmë zgjidhjen për ta sa i përket buxhetit të tyre.

Kryetarja, tha se vizitat do të realizohen gjithsesi. Ka pasur vonesa për shkak të çështjeve të hapura dhe të cilat kishin afate të caktuara.

Salihe Mustafa, tha se për shqetësimet e z.Paçaku për shoqatën Handikos në Prizren, qëllimi ishte që personat me aftësi të kufizuar të kenë trajtim më të madh nga Komuna në e biseduam edhe në grup punues, dhe kemi propozuar që shuma shtesë që jepet për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë në shumë prej 50 euro, të jetë 60, që sado pak të kenë ndikim në përmirësimin e gjendjes së tyre.

Nenad Rashiq, tha se palët që i kishin në takim të grupit punues ishin të nevojshme sepse ligji duhet të implementohen. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për herë të tretë nuk ka marrë pjesë në takim edhe pse ka qenë e ftuar, të bëjmë një shkresë më kritike sa i përket përgjigjes së tyre në ftese, sepse ata janë organi përgjegjës që duhet me e zbatua ligjin, dhe duhet të marrin pjesë në takime të grupit punues. Nga Ministria e Financave kemi kërkuar koston sekondare të këtij projektligji, po ashtu kemi pasur një propozim për rritje të lehtë të shumës nga 50 në 60 euro, po është problem zbatimi i Ligjit në nivel lokal. Kemi menduar për një fushat sensibilizuese të nivelit lokal, kemi problem ku KEDSI shkyç të gjithë ata që nuk paguajnë rrymën, ky është një memorandum mes Ministrisë së Punës, Ministrisë së Financave, asaj të Zhvillimit Ekonomik dhe KEDS-it, Ministria e Financave paguan borxhin me vonesë diku në muajin prill, dhe KEDSI bën shkyçje të këtyre familjeve. Ministria e Financave duhet ta bëjë pagesën me kohë dhe të zbatohet ky memorandum, në mënyrë që mos t'ju shkaktojë familjeve me nevojë probleme në këtë drejtim.

Po ashtu, të kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë, Departamenti Ligjor një rekomandim se a është ky projektligj në harmoni me ligjin për shëndetësi, këto janë disa pika që janë evidentuar nga takimi i grupit punues për projektligjin.

Kujtim Paçaku: Falënderoj z.Rashiq, i cili shpjegoi gjendjen faktike e cila është. Ai tha se ligji për përfituesit e skemës sociale përjashton familjet që kanë fëmijë të moshës mbi 5 vjeç, atëherë numri aktual i përfituesve të skemës sociale është shumë herë më i madh sepse ky ligj na ka ngelur nga UNMIK-u, dhe keni plotësisht të drejtë kur thoni për KEDS-in, se nga moszbatimi i kësaj, po vuajnë edhe familjet e komunitetit rom dhe familje të komuniteteve të tjera.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se nga plani i punës jemi mbështet edhe në vizitat nëpër komuna në Njësitin për të Drejtat e Njeriut. Nga të gjitha punët e planifikuara, shumicën i kemi realizuar. Në sesionin pranveror të barten disa nga punët e përfunduar.

Ajo tha se brengosëse ishin sfidat e Hendikosit. Ne do të vizitojmë Shoqatën Hendikos në Prizren, Ferizaj etj.

Jemi në proces të monitorimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje. Kishim disa vizita nëpër ministri. Kemi pasur të ftuar koordinatorin nacional kundër dhunës në familje, kemi evidentuar të gjitha ato që kanë dalë si rezultat i këtyre vizitave dhe besoj se edhe ky monitorim do të përfundojë në sesionin pranveror.

Etem Arifi, tha se si komision kemi punuar mjaftë, por kërkohet ende një angazhim shtesë, sepse jemi duke u marrë me disa sfida që po ballafaqohen kategoritë e veçanta të shoqërisë sonë, dhe të jemi syçelë sepse nevojat e tyre janë të shumta dhe ne të kemi kujdes që të japim kontribut që sa do pak të ndikojmë në përmirësimin e kushteve të tyre jetësore.

Kryetarja, falënderoi të gjithë anëtarët e komisionit dhe të pranishmit që së bashku kontribuan në punët e komisionit, dhe bëri thirrje që vitin e ardhshëm t'i bashkohen komisionit dhe punëve të përbashkëta edhe kolegët deputetë të opozitës, sepse agjenda është më e përmbushur, dhe të gjithëve ju uroj që viti 2016, të jetë një vit i mbarë për të gjithë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi

